



KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 9.7.2019

Dokument parlamentar

RAPORT PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË, (HUAMARRËSI), FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT (AGJENCIA E ZBATIMIT TË PROJEKTIT), DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR PROGRAMIN E FURNIZIMIT ME UJË TË ZONAVE RURALE IV”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 - 38 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, (huamarrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (agjencia e zbatimit të projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV”, në mbledhjen e tij të datës 9 korrik 2019.

Komisioni caktoi relator për këtë projektligj Zotin Arben PËLLUMBI.

Të pranishëm gjatë shqyrtimit të projektligjit ishin përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, (huamarrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (agjencia e zbatimit të projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV” është nismë e Këshillit të Ministrave dhe i paraqitet për shqyrtim Kuvendit mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Projektligji synon ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, (huamarrësi), Fondit Shqiptar të Zhvillimit (agjencia e zbatimit të projektit), dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për programin e furnizimit me ujë të zonave rurale IV”. Ky investim është pjesë e një pakete mbështetëse të financuar nga Qeveria Gjermane përmes KfW-së.

Programi sektorial i ujërave/furnizimi me ujë i zonave rurale IV, i përgjigjet prioriteteve dhe qëllimeve të vëna për zhvillimin ekonomik të vendit. Gjithashtu, ky program mbështetet në Strategjinë Kombëtare për Furnizimin me Ujë dhe Kanalizimet dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015 – 2020.

Vlera totale e projektit është 45.1 milionë euro. Investimet e fazës së katërt të programit të furnizimit me ujë të zonave rurale do të shtrihen në një zonë projekti që përfshin zonën bregdetare të jugut të Shqipërisë, duke u fokusuar në Bashkinë e Himarës dhe Bashkinë e Vlorës me fokus njësinë administrative Orikum. Një pjesë prej 40 milionë euro do të financohet nga kjo hua e akorduar nga KfW-ja, një pjesë prej 2 milionë euro do të financohet me një grant të ajorduar nga KfW-ja, një pjesë prej 1.35 milionë euro do të financohet nga buxheti i shtetit dhe pjesa tjetër prej 1.8 milionë euro do të financohet nga një grant i akorduar nga Korniza e Investimeve të Ballkanit Perëndimor WBIF-ja.

Kjo marrëveshje ka për qëllim financimin e fazës së katërt të programit të furnizimit me ujë të zonave rurale, nëpërmjet akordimit nga KfW-ja të një huaje në shumën 40 milionë euro. Termat financiarë të marrëveshjes janë si më poshtë:

-Shuma e huas:	40 000 000 euro;
-Interesi:	Normë fikse e interesit që përcaktohet në momentin e bërjes efektive të huas;
-Tarifa e menaxhimit:	1% e shumës së huas;
-Tarifa e angazhimit:	0.25% në vit, që llogaritet mbi shumën e padisbursuar të huas;
-Maturimi:	15 vjet, duke përfshirë periudhën prej 3 vitesh pa pagesë principali.

Norma e interesit të huas nuk përcaktohet në marrëveshje, por është dakordësuar në marrëveshje se kjo normë do të përcaktohet nga KfW-ja dy ditë pune nga marrja e njoftimit tonë se janë përmbushur kushtet e bërjes efektive të marrëveshjes së huas. Bazuar në historikun e bashkëpunimit me KfW-në si një partner i besueshëm zhvillimi, kryesisht kreditë e akorduara nga kjo e fundit në dhjetë vitet e fundit kanë pasur norma interesi të fiksuara në nivelin prej rreth 1-2%. Edhe për këtë huanë e marrë me këtë marrëveshjeje, parashikohet që norma të jetë poshtë nivelit prej 2%.

Faza e katërt e programit të furnizimit me ujë të zonave rurale do të zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në cilësinë e agjencisë së zbatimit të projektit, në vijim të fazave të implementuara më herët, përkatësisht faza e parë, e dytë dhe e tretë.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me nenet 78, 83, pika 1, dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, si dhe me ligjin nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 2 nene.

- ***Diskutimi në komision***

Relatori i projektligjit u shpreh që realizimi i këtij programi do të ndikojë në furnizimin e qëndrueshëm me ujë të pijshëm për banorët dhe turistët në zonën e projektit, me kosto sociale të pranueshme dhe tarifa që i mbulojnë kostot.

Përfaqësuesit e Ministrisë shpjeguan termat financiarë e teknik kryesorë të kësaj marrëveshjeje, si dhe kontributin që do të ketë zbatimi i këtij projekti në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të promovojë zhvillimin e turizmit në zonën e projektit duke e çuar numrin e përtituesve në 80 000 përfshirë turistët.

Diskutimet në Komision, u përqëndruan kryesisht në termat financiarë të marrëveshjes financiare; si dhe projektet konkrete që mund të realizohen me këtë marrëveshje.

- ***Përfundim***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni vlerësoi projektligjin për krijimin e mundësive për përmirësimin e infrastrukturës së ujësjellësve dhe të kanalizimeve, nëpërmjet sigurimit të aksesit të qëndrueshëm në furnizimin me ujë të pijshëm për banorët dhe turistët në zonën e projektit, me kosto sociale të pranueshme dhe tarifa që i mbulojnë kostot, si dhe me sanitete të përshtatshme nëpërmjet sistemit të kanalizimeve, grumbullimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe përmirësimit të kapaciteteve menaxhuese.

Komisioni e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi me të gjitha votat e anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare, duke i sugjeruar FSHZH-së që të shohë mundësinë që në këtë projekt të përfshihen edhe fshatrat e Kallararit, Bolenës, Vranishtit e Tërbaçit, të cilat janë pjesë e kësaj zone, duke përorur tepricat e mundshme financiare të projektit.

Arben PËLLUMBI

Niko PELESHI

Relator

Kryetar